




LE

M E S H A

E

SHËN JAN GOJARTIT



TE ZENIT

Dia. - Bekò, o Zot.

Pri. - Bekuarë rregjëria e Atit, e Birit edhè e Shpirtit Shejt, nanì e gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Pop. - Amin.

Dia. - Në pakje parkalesiën t'ën'Zonë.

Pop. - Lipisi, o i Madh'in'Zot.

(Edhè kështu te të jerët lutje).

Dia. - Për pakjen s'larti e për shëndetën e shpirtravet t'anë, parkalesiën t'ën'Zonë.

Për pakjen e gjithë jetës tërë, e për kjëndresën e Klishëvet shejte të Perëndis, e sa të gjitha një të jenë, parkalesiën t'ën'Zonë.

Për këtë shpi t'shejte e për atà çë këtù hijën me besë, me ponì e me trëmbësi të Perëndis, parkalesiën t'ën'Zonë.

Për Episkopin t'ënë (...), për të ndershmen priftëri e diakéri te Krishti, për gjithë klerin e populin, parkalesiën t'ën'Zonë.

Dia. - Për të Parët t'anë, për gjithë shpin e ushtrin e 'tire, parkalesiën t'ën' Zonë.

Për Horën t'ënë e për nga kjitet edhë horë e përgatà çë ijesiën me besë, parkalesiën t'ën' Zonë.

Për motin e mirë, për burimin e pemëvet të dheut e për kjëronje të pakjëshmë, parkalesiën t'ën' Zonë.

Për atà çë janë mbi dejt, për në dhromë, të sëmurë, çë janë e riejën, për atà çë janë në fulakjì e për shëndetën e 'tire, parkalesiën t'ën' Zonë.

Sa të na ruanjë nga çëdò helme, mbëri, rrëzikje e mierì, parkalesiën t'ën' Zonë.

Ndihëna, shpëtona, kijna lipisi dhe ruana, o Perëndì, me hirin t'ënt.

Tue përmendurë Zonjën t'ënë po Virgjérë, Mëmën e Perëndis, Shën Mërin, gjithë shejte, të dëlirë, të bekuame dhe të lëvduame, bashkë me gjithë shejtrat, na e njeri me t'jetrin e gjithë gjellën t'ënë i trajëm Zotit Krisht Perëndì.

Pop. - Tij, o i Madh'in'Zot.

Pri. - Se Tij të nget nga lëvdì, nder e të përmisur: Atit, Birit e Shpirtit Shejt, nani e gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Pop. - Amin.

ANTIFONA E PARË

Bukur isht të lëvdojëm t'ën' Zonë e të këndoja jëm embrin t'ënt, o i larti Perëndi.

Për parkalesit të Mëmës t'ënde, o i Madh'in' Zot, shpëtona.

Lëvdì past Ati, Biri edhë Shpirti Shejt, nani e gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin.

Për parkalesit të Mëmës t'ënde, o i Madh'in' Zot, shpëtona.

Dia. - Pameta në pakje parkalesiën t'ën' Zonë.

Pop. - Lipisi, o i Madh'in' Zot.

Dia. - Ndihëna, shpëtona, kijna lipisi dhe ruana, o Perëndi, me hirin t'ënt.

Pop. - Lipisi, o i Madh'in' Zot.

Dia. - Tue përmendurë Zonjën t'ënë po Virgjérë, Mëmën e Perëndis, Shën Mërin, gjithë shejte, të dëlirë, të bekuame dhe të lëvduame, bashkë me gjithë shejtrat, na e njeri me t'jetrin e gjithë gjellën t'ënë i truajëm Zotit Krisht Perëndi.

Pop. - Tij, o i Madh'in' Zot.

Pri. - Se jotia ë pushtetia, si edhë rregjëria e fukja e lëvdia: e Atit, e Birrit edhë e Shpirtit Shejt, nani e gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Pop. - Amin.

ANTIFONA E DYTE

In'Zot rregjëron e pështronet me nder të math;
In'Zot vishet e me fukji rrethonet.

Për parkalesitë të shejtravet t'atë, o i Madh'
in'Zot, shpëtona.

Lëvdi past Ati, Biri edhë Shpirti Shejt, nani
e gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin.

O i vetmi Bir e Fialë e Perëndis, Ti çë je i
pavdekshim, deshe të njerëzoneshe e të mirrie
kurm për shëndetën e shpirtit t'ënë në gji të
Shejtes Mëmë e po Virgjërë e Shën Mëri.

Ti çë pa ndërruarë njeri u bërë e vënë n'krikj,
o Krisht o Perëndi, me mortien t'ënde mortien
shkele, Ti çë je një nga Trinia Shejte bashkë-
lëvduar me Atin e me Shpirtin Shejt, jipëna
gjellë të pasosme.

Dia. - Pameta në pakje parkalesiën t'ën'Zonë.

Pop. - Lipisi, o i Madh'in'Zot.

Dia. - Ndihëna, shpëtona, kijna lipisi dhe ruana,
o Perëndi, me hirin t'ënt.

Pop. - Lipisi, o i Madh'in'Zot.

Dia. - Tue përmendurë Zonjën t'ënë po Virgjërë,
Mëmën e Perëndis, Shën Mërin, gjithë shejte,
të dëlirë, të bekuame dhe të lëvduame,
bashkë me gjithë shejtrat, na e njeri
me t'jetrin e gjithë gjellën t'ënë i tru-
ajëm Zotit Krisht Perëndi.

Pop. - Tij, o i Madh'in'Zot.


Pri. - Se Ti je Perëndì i mirë e çë do mirë
njerëzit e na të japiëm lëvdì Tij: Atit,
Birit edhë Shpirtit Shejt, nani e gjithë-
monë e për jetë të jetëvet.

Amin.

ANTIFONA E TRETE

Ejani të gëzonemi tek in'Zot; ngrëjëm zërin me
hajdì Perëndis, shëndeta jonë.

Shpëtona, o i Biri i Perëndis, i famasëshmë
ndër shejtrat (tek e diellia thuhet: I ngjalluri
së vdekurish), neve çë të këndojojmë: Alliluia



HIRIA E VOGËL

Dia. - Dieja ! Shtuara.

Pop. - Ejani t'i falemi e t'i përmisemi Zotit
Krisht. Shpëtona, o i Biri i Perëndis,
i famasëshmë ndër shejtrat (tek e diellia
thuhet: I ngjalluri së vdekurish), neve
çë të këndojojmë : Alliluia.

(Sglidhen tropariet).

(Prifti parkalesë)

Dia. - Parkalesiäm t'ën'Zonë.

Pop. - Lipisi, o i Madh'in'Zot.

Pri. - Se ti je i Shejt, o Perëndia jinë, e na
të japiëm lëvdì Tij: Atit, Birit e Shpir-
tit Shejt, nanì e gjithëmonë e për jetë
të jetëvet.

Pop. - Amin.

Pop. - Shejt Perëndi, Shejt i fukjishëm, Shejt
i Pavdekshëm, kij lipisi për ne (3 herë).

Levdi past Ati, Biri e Shpirtit Shejt,
nanì e gjithëmonë, e për jetë të jetëvet.
Amin.

Shejt i pavdekshëm, kij lipisi për ne

Dia. - Fukji.

Pop. - Shejt Perëndi, Shejt i fukjishëm, Shejt
i Pavdekshëm, kij lipisi për ne.

Oh sa në Krisht u pagzuat, me Krishtin
u veshët. Alliluia.

Krikjen t'ënde proskjinisiäm, o i
Madh'in'Zot, e ngjallien t'ënde të
shejte lëvdojëm.

Dia. - Vumëji 're ! Dieja ! Gjegjemi !

(Sglidhet pistulla; si sos thuhet:)

Pop. - Alliluia ! (3 herë).



VANGEJI

Pri. - Dieja ! Shtuara, gjegjemi Vangejejin
Shejt.

Pakje të gjithëve.

Pop. - Edhë shpirtit t'ënt.

Dia. - Piesë e Vangjejit Shejt si shkruan
Shën (Mateu; Marku; Luka; Jani).

Pop. - Lëvdi Tij, o i Madh'in'Zot, lëvdi Tij.

Pri. - Gjegjemi !

(Sglidhet Vangjeji; si sos thuhet:)

Pop. - Lëvdi Tij, o i Madh'in'Zot, lëvdi Tij.
Për shumë viet, o Zot.

Dia. - Të gjithë po thomi me gjithë zëmbër e
me gjithë mendien t'ënë, po thomi.

Pop. - Lipisi, o i Madh'in'Zot.

(Edhë kështu te të jerët lutje)

Dia. - O Zot i gjithëmëndëm, Perëndia i Atëravet t'anë, na të parkalesiën, Ti gjegjëna e kijna lipisi.

Kijna lipisi, o Perëndi, për sa e madhe isht lipisia jote, na të parkalesiën, Ti gjegjëna e kijna lipisi.

(Prifti parkales).

Dia. - Parkalesiën edhë për Episkopin t'ënë (...) e për të ndershëmen priftëri.

Parkalesiën edhë për vëllezërit t'anë priftëra, kallogjerë, diakëra e për gjithë vëllezërin t'ënë në Krisht.

Parkalesiën edhë për lipisi, pakje, shëndetë shpëtim, kujdes, falie e ndjesë të mëkatëvet të shërbëtorvet të Perëndis, çë rrojën te kjo horë.

Parkalesiën edhë për atà të lumë e të paharruashëm çë stisën këtë Klishë snejte e për gjithë prindrat e vëllezërit t'anë çë vdkjën me besën e çë flën varrëzuar këtù e ku do ndodhen.

Parkalesiën edhë për të besmitë çë ndihiën e shërbejën mirë këtë e ndershëme Klishë shejte, për atà çë i sbiren e i këndojën e për gjithë popullin çë këtù ndodhet e pret nga Ti të mëdhà e të shuma lipisit t'ote.

Pop. - Për shumë vietë, o Zot.

Pri. - Sa na tē ruajtur, pēr herē, nga pushtetia jote, tē japiēm lēvdì Tij: Atit, Birit, e Shpirtit Shejt, nanī e gjithëmonë e pēr jetē tē jetëvet.

Pop. - Amin.

Na këtù Hjeruvimtë mistikjisht tue shfa-kjurit edhè na Trinis Shejte gjallsore trishejten kënkek tue kënduarith, po lëmë mbë nj'anë e gjellës çëdò kujdes, sa tē presiēm Rregjin...

(Prifti parkales)



HIRIA E MADHE

Pri. - U kujtoftë Perëndia i Madh'in' Zot pēr ne tē gjithë te rregjëria e 'tij, pēr herë, nanī e gjithëmnë e pēr jetē tē jetëvet.

Pop. - Amin.

Pop. - ... Sa tē presiēm Rregjin e gjithësis, çë rrethuar vienë pa parë tufa tufa Engjëjish. Alliluia, Alliluia, Alliluia.

Dia. - Le tē mbarojëm parkalesin t'ënë t'in' Zoti.

Pop. - Lipisi, o i Madh'in' Zot.

(Edhè kështu te të jerët lutje)

Dia. - Për dhuretit të çëmuame këtu paravuna, parkalesiën t'en' Zonë.

Për këtë shpi shejte e për gjithë atà që këtu hijën me besë, me ponì e me trëmbësi të Perëndis, parkalesiën t'en' Zonë.

Sa të na ruanjë nga çëdò helme, mbëri, rrëzikje e mierì, parkalesiën t'en' Zonë.

(Prifti parkales).

Dia. - Ndihëna, shpëtona, kijna lipisi dhe ruana, o Perëndi, me hirin t'ënt.

Të na shkonjë gjithë dita e mbaruame më se më, e shejte, me pakjen e pamëkatë, lipëmia t'in' Zoti.

Pop. - Gjegjëna, o i Madh'in' Zot.

(Edhè kështu te të jerët lutje)

Dia. - Engjëllin e pakjes, çë i besmë na kjellë te dhromi i drejtë e që ruanë shpirrat e kurmet t'anë, lipëmia t'in' Zoti.

Ndëjesën e falien e mëkatëvet e të fajevet t'anë, lipëmia t'in' Zoti.

Kjëroin çë na vietet të gjellës t'enë të e sosiën me pakje e me pendes, lipëmia t'in' Zoti.

Dia. - Të mirat e çëdò i duhet shpirtravet t'anë e pakjen pér jetën, lipëmia t'in'Zoti.

Si të krështerë të sosurit e gjellës t'ënë, pa dhëmbie, pa të kjërtuamë, në pakje e me mbrojtje të mirë përparrë gjikjitetë dreruashëm të Krishtit, lipëmia t'in'Zoti.

Tue përmendurë Zonjën t'ënë po Virgjërë, Mëmen n e Perëndis, Shën Mërin, gjithë shejte, të dëlirë, të bekuame dhe të lëvduame, bashkë me gjithë shejtrat, na e njeri me t'jetrin e gjithë gjellën t'ënë i truajëm Zotit Krisht Perëndi.

Pop. - Tij, o i Madh'in'Zot.

Pri. - Për lipisit e të vetëmit ler t'it Biri, me të çilin je i bekuar, bashke me të gjithë shejtin të mirë e gjellëdhënës Shpirt t'ënt, nani e gjithëmonë, e pér jetë të jetëvet.


Pop. - Amin.

Pri. - Pakje të gjithëve

Pop. - Edhë shpirtit t'ënt.

Dia. - Të duhem mirë njeri me t'jetrin sa njëi mendie të ligjerojëm:

Pop. - Atin, Birin e Shpirtin Shejt, Trininë me një të klënëtë e të pandarshme.




U KAM BESË

Dia. - Diert ! Diert ! Me urtësi. Vumëji 're.

Pop. - U kam besë te një Perëndì, At i gjithë-mëndëm, çë bëri kjiellin e dheun, e gjithë të dukurat e të padukurat. Edhë te një Zot, Iisù Krishti, i Biri i Perëndis, i vetmi ler, i çili leu nga Ati më para se gjithë jetët; Dritë nga Dritë, Perëndi i vërtet nga Perëndì i vërtet; i ler, jo i bër, gjithë një klénie me Atin, pér anë të të çilit gjithëkjishë u bënë. I çili pér ne njerëzë e pér shpëtimin t'ënë u sdrip nga kjiellia e mori kurm paj të Shpirtit Shejt e te Vir-gjérës Mëri e u bë njeri. Kle vun n'krikjë pér ne nën Ponts Pilatit, duroi e kle varrëzuar; e ugjallë të tretën ditë si thonë të shkruamet; e u ngjip te kjiellia e rri te ana e drejtë t'Atit. E ka të vinjë pameta me lëvdì të bënë ligjë mbi të gjallit e mbi të vdekurit; Rregjëria e Tij ngë ka pér të sosur. E te Shpirti Shejt, Zot, Gjellëdhënës, çë buròn nga Ati, e ë përmisur bashkë me Atin e me Birin,

e çë foli pér anë të profet travet. Te Klisha, shejte, katholike e apostolike. U rrëfienjë një pagëzim pér ndëjesën e mëkatëvet. Pres ngjallien e të vdekurvet e gjellën e jetës së jardhëshmë. Amin.



ANAFORA

Dia. - Rrim me lutësi ! Rrim me trëmbësi ! Vumëji 're të faliëm Shejten Dhureti në pakje.

Pop. - Lipisi pakje, flijë lëvdimi.

Pri. - Hiri i t'in' Zoti Iisù Krishti e dashuria e Perëndis At, e të marrit piesë të Shpirtit Shejt, kloft me ju të gjithë.

Pop. - Edhë me shpirtin t'ënt.

Pri. - Ngrëjëm në të lartit zëmbratë t'ona.

Pop. - I kemi tek in' Zot.

Pri. - Haristisiëm t'ën' Zonë

Pop. - Mirë isht e drejt t'i përmisemi Atit, Birit e Shpirtit Shejt,: Trinis me një të klënëtë

e të pandarshme

(Prifti parkales).

Pri. - E kënkën e mundësës tue kënduar, tue 'luritur, tue thërritur e tue thënë:

Pop. - I Shejt, I Shejt, I Shejt, Zoti Savaoth. kjielli e dheu janë plotë me lëvdin t'ënde. Osannà te më i larti kjiell. I bekuar ai çë vien në embër të t'in'Zoti. Osannà te më i larti kjiell.

(Prifti parkales).

Pri. - Mirrëni, hani: Ki isht Kurmi i jimë, çë cahet për ju për ndëhesë të mëkatëvet.

Pop. - Amin.

Pri. - Pini prej këtij të gjithë: Ki isht Gjaku i jimë, të Dhiatës së re, çë derdhet për ju e për shumë për ndëjesë të mëkatëvet.

Pop. - Amin.

Pri. - Na Tij të faliëm t'otet nga t'otet ndër të gjitha e mbi të gjitha.

Pop. - Të lëvdojëm, të bekojëm, të haristisiëm, o i Madh'in'Zot, e të parkalesiëm, o Perëndia jinë.

(Prifti parkales).

Pri. - Më se më për Mëmën e Perëndis të gjithë shejte, të dëlirë, të bekuame edhë të lëvduame, Zonjën t'ënë po Virgjërë Mëri.

Pop. - I mathë isht embri i Trinës Shejte.

Shumë mir'isht me të vërtetë sa të thomi Tij të lume Zonjë për gjithëmonë t'lumëshme dhe të papërlieme edhë Mëmë të të Madhit Zot.

Tij më të nderoshme se Hjeruvimtë e pa të përkrahur më të lëvdoshme se Serafimët, çë pa fare u ndotur të lartën Fialë linde, vërteta Mëma t'Zotit, po madhërojëm na.

(Prifti parkalese).

Pri. - Ndër të parët kujtou, o i Madh'in'Zot, për Episkopin t'ënë (...) kuj jipi të jetë për Klishtë t'ote shejte, i ruajtur, i ndermë, me pakje, me ditë të glata, sa të ligjëronjë drejt fialën e vërteties s'ate.

Dia. - Edhë për ghithë atà çë nga njeri neshë ka në mendie. E për të gjithë e për të gjitha.

Pop. - Për të gjithë e për të gjitha.

(Prifti parkales).

Pri. - E jipëna sa me një gojë e me një zëmbër të lëvdojëm e të këndojëm të gjithëmëndërshtmin e të madhëruashmin embër t'ënt: të Atit, të Birit e të Shpirtit Shejt, nani e gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Pop. - Amin.

Pri. - E lipisit e të Madhit Perëndi e Shpëtu-
esi jinë Iisù Krishti, klofshin me ju të
të gjithë.

Pop. - Edhè me shpirtin t'ënt.

Dia. - Posa kemi përmendurë gjithë shejtrat,
pameta në pakje parkalesiën t'ën' Zonë.

Pop. - Lipisi, o i Madh'in' Zot.

(Edhè kështu te të jerët lutje).

Dia. - Për të çëmuamet Dhureti paravuna e të
shejtëruame, parkalesiën t'ën' Zonë.

Sa Perëndia jinë çë njeriun do mirë e
çë i mori me hir mbi shejten therore të
'Tij të kjiellshmë e të mendëshme si
bukur erë shpirtulliore, nanë na dhëfshitet
Hirin të perëndishëm e Dhuratën e Shpir-
tit Shejt, parkalesiën t'ën' Zonë.

Sa të na ruanjë nga çëdë helme, mbëri,
rrëzikje e mierë, parkalesiën t'ën' Zonë.

(Prifti parkales).


Dia. - Ndihëna, shpëtona, kijna lipisi dhe ruana,
o Perëndi, me hirin t'ënt.

Pop. - Lipisi, o i Madh'in' Zot.

Dia. - Posa lipëm njënin e besës e të marrit
piesë të Shpirtit Shejt, na njeri me
t'jetrin e gjithë gjellën t'ënë i truajëm
Krishtit Perëndi.

Pop. - Tij, o i Madh'in'Zot.

Pri. - E bënna tē mirë, o i Madh'in'Zot, sa
me besë e pa ftesë tē kudsojëm tē tē
thërresiäm Tij si Tate, Perëndì i kjie-
llëshëm, e tē tē thomi:



ATI I JINË

Pop. - Ati i jinë çë je në kjiell, shejtëruar
kloft embri jit, arthët rregjëria jote,
u bëft vullimi i jit, si ndë kjiell
ashtu në dhe.

Bukën t'ënë tē përdicëmen ëna neve sot,
ndëjena dëtirët t'ona, ashtu si na ja
ndëjejëm tē dëtëruamvet t'anë, e mos na
le tē biem ndë ngarie, po lirona nga i
ligu.

Pri. - Se jotia isht rregjëria , fukjia e lëv-
dia: e Atit; e Birit edhë e Shpirtit
Shejt, nani e gjithëmonë e për jetë tē
jetëvet.

Pop. - Amin.

Pri. - Pakje të gjithëve
Pop. - Edhë shpirtit t'ënt.
Dia. - Ujëni kriet t'ajë t'in'Zoti.
Pop. - Tij, o i Madh'in'Zot.
(Prifti parkales).

Pri. - Me hirin e me lipisitë e me mirësin
çë ka me ne jit Bir i vetëmi ler, me
të çilin je i bekuar bashkë me Shpirtin
t'ënt gjithë shejt, të mirë e gjellë-
dhënës, nanë e gjithëmonë e për jetë
të jetëvet.


Pop. - Amin.
(Prifti parkales).

Dia. - Vumëji 're.
Pop. - Për ndihëmë të gjithë të besmëvet të
krështerë të vërtetë.
Pri. - Të Shejtetë Shejtravet.
Pop. - Një i Shejt, një i Zoti, Iisù Krishti,
në lëvdì të Atit Perëndì. Amin.

Kinonikòn

E diellia: Lëvdoni t'en'Zonë nga kjiellia;
lëvdoni Atë te më i larti kjiell.
Alliluia, alliluia, alliluia.

- E hénia: Ài çë bëri frima Ëngjëjit e 'tij
e shërbëtorët e tij flaka ziarri.
Alliluia, alliluia, alliluia.
- E martia: Në kujtim të pasosëm ka t'jet i
drejti; e ngë ka të trëmbetpër zë
të kekjë. Alliluia, alliluia, alliluia.
- E mërkuria: Kjelkjin e shëndeties u dua të marrë;
embrin e t'in'Zoti u dua të thérres.
Alliluia, alliluia, alliluia.
- E intia: Te gjithëjeta dolli zëri i tire;
te gjithë anët e botës fialët e tire.
Alliluia, alliluia, alliluia.
- E prëmtia: U dëftua mbi ne drita e fakjes t'ënde,
o i madh'in'Zot. Alliluia, alliluia,
alliluia.
- E shtunia: Të lumë atà çë Ti sglodhe, o i Madh'-
in'Zot; kujtimi i tire brez pas brezi.
Alliluia, alliluia, alliluia.
-
- Pop. - Të darkës t'ënde mistike, o i Biri i
Perëndis, vur sot në piesë edhë mua; se
u armikjëvet t'atë Misterin t'ënt ngë i
thomë, e ngë të puthë si të puthi Judha,
po si kusari i mirë të thomë: për mua
khjtou o Zot; për mua kujtou o Krisht,
për mua kujtou o Rrekj, te rregjëria jote.



KUNGIMI

Dua. - Me trëmbësi të Perëndis, me besë e me dashuri, kjasij.

Pop. - Amin. Amin. I Bekuar ai çë vien në embër të t'in'Zoti; Perëndia Zot edhë na u dëftua neve.

(Prifti dhuròn kungimin. Si sos bekòn gjinden tue thënë:)

Pri. - Shpëtò, o Perëndi, popullin t'ënt, edhë bekò trazhgimin t'ënt.

Pop. - Për shumë vietë, o Zot.

Pam Dritën e vërtetë, muartëm Shpirtin të kjielliës, gjetëm besën e vërtetë, tue u falur përmistë Trinis të pandarshëme, se kjo neve na shpëtoi.

Pri. - ... Për herë, nani e gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Pop. - Amin.

Per ndëjesë të mëkatëvet e për gjellë të pasosme. Alliluia, alliluia, alliluia.

Dia. - Shtuara; na çë u kemi kënguarë me misteretë të Krishtit, të Perëndishëm, të shejtë, të dëlirë, të pavdekshëm, të kjiellëshëm, gjellëdhënësë, të dreruashëm, si nget haristisiëm t'ën'Zonë.

Pop. - Lipisi, o i Madh'in'Zot.

Dia. - Ndihëna, shpëtona, kijna lipisi dhe ruana, o Perëndi, me hirin t'ënt.

Pop. - Lipisi, o i Madh'in'Zot.

Dia. - Tue lipur të na shkonjë gjithë dita e mbaruamemë se më, e shejte, me pakjen e pamëkatë, njeri me t'jetrin e gjithë gjellën t'ënë i truajëm Zotit Krisht Perëndi.

Pop. - Tij, o i Madh'in'Zot.

Pri. - Se Ti je të shejtëruamit t'anë e na të japiëm lëvdì Tij: Atit, Birit e Shpirtit Shejt, nanë e gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Pop. - Amin.

Pri. - Le të vemi me pakjen.

Pop. - Me embrin e t'in'Zoti.

Dia. - Parkalesiëm t'ën'Zonë.

Pop. - Lipisi, lipisi, lipisi o i Madh'in'Zot.
Bekò, o Zot.

Pri. - O i Madh'in'Zot, çë bekòn atà çë të bekojën e shejtéròn atà çë tek Ti kan besë, shpëtò popullin t'ënt e bekò trazhgimin t'ënt. Ruaj plotësin e Klishës s'ate, shejtérò atà çë duan hjen e shpis s'ate. Ti kthei lëvdin me fukjin t'ënde të perëndishëme, e mos na le neve çë kemi shpresën tek Ti. Ti dhurò pakjen jetës s'ate, klischëvet t'ote, priftëris, të parëvet t'anë, ushtris e gjithë pullit t'ënt; se çëdò të dhënë të mirë e çëdò dhuratë e përsosur vies së larti, sdripet ngak Ti. Ati i dritëvetë, e na të japiëm lëvdin, të haristikurit e tE përmisurit Tij, Atit, Birit e Shpirtit Shejt, nani e gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Pop. - Amin.

Embri i t'in'Zoti kloft i bekuar nani e për ghithëmonë (3 herë).

Dia. - Parkalesiëm t'ën'Zonë.

Pop. - Lipisi, o i Madh'in'Zot.


Pri. - Bekimi i t'in'Zoti e lipisia e 'Tij arthët mbi ju me hirin e 'Tij e me mirësin, për herë, nani e gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Pop. - Amin.

Pri. - Lëvdì Tij, o Perëndia jinë, shpresa jonë, lëvdì Tij.

Pop. - Lëvdì past Ati, Biri e Shpirti Shejt, nani

e gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin.
Lipisi, lipisi, lipisi, o i Madh'in'Zot.
Bekona, c Zot.



TE DËRGUARIT

Pri. - Krishti Perëndia jinë i vërtetë, i famasëshëm ndër shejtrat (tek e diellia thuhet: i ngjalluri së vdekurish), për parkale-sit të Mëmës s'Tij, e dëlirë e e pamëkatë, me fukjin e Krikjes shejte e gjellëdhënëse, me mbrojtje të të ndershshmëvet pushtetie të poshpirtëshme të kjielliës, për lutiet e të ndershmit e të lëvduashmit Profetë e Paradhromë Shën Jani Pagzor, paj të lëvduashmëvet shejtra Apostoj të përmendëshim e të shejtrat deshmorë mundësorë, paj të shejtravet Atëra t'anë e të Atit t'ënë ndër shejtrat Shën Jani Gojartë, Arkjiepiskopë të Kostantinopolit, paj të shejtravet të drejtë Gjishëra të Perëndis Shën Jakini e Ana të shejitit

(të Klishës), të shejtit (të ditës) çë sot përmendiëm, edhë të gjithë shejtravet, na paçit lipisi e na shpëtoftë, si i mirë e çë njeriun do mirë..

Pop. - Amin.

Parrocchia
S. Antonio il Grande
Piana degli Albanesi

